



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	23.07.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-138869/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	Bashkësia e Popullit të Zotit – Leonora Kurti
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	<b>Pëlqim</b>

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokolli 07-353/04-138869/21 nga Bashkësia e Popullit të Zotit me përfaqësuese Leonora Kurti - Administratore me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike, sheshi “Nëna Tereze” dhe “Zahir Pajaziti” nga data 12 deri me datë 15 Gusht 2021.

Qëllimi i aktivitetit është zhvillimi i performancës akrobatike nga një grupet mysafirësh Italian i quajtur “ScegliGesù”.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 12 dhe 13 Gusht 2021.

Arsyeja e ndërrimit të lokacionit është sepse dy sheshet e kërkuara nga ju janë të ngarkuara me aktivitete të tjera.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve si dhe pas përfundimit të aktivitetit sheshi të kthehet në gjendjen e më parshme;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.